

**Inform Albania Sh.p.k**  
**Raporti i Audituesit të pavarur dhe**  
**Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

**PËRMBAJTJA:**

	<b>FAQE</b>
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	6
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	7 - 22

## **RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR**

### **Për Menaxhimin dhe ortakët e Shoqërisë Inform Albania sh.p.k**

#### **Opinion**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë **Inform Albania shpk** (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 Dhjetor 2019, pasqyrën e performancës, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 Dhjetor 2019, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara në Shqipëri.

#### **Baza për Opinionin**

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

#### **Theksim çështje**

Ne tërheqim vëmendjen për shënimin 4 të pasqyrave financiare, i cili përshkruan vlerësimin e menaxhimit në lidhje me ndikimin aktual dhe potencial të pandemisë së COVID - 19 dhe të masave kufizuese të lidhura me kompaninë. Opinioni ynë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

#### **Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuiojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

#### **Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose te marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

8 prill 2020



---

**Luan Kamberi**  
Auditues Ligjor

Pasqyra e Pozicionit Financiar  
më 31 dhjetor 2019

	Shënime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
<b>AKTIVET</b>			
<b>Aktive afatshkurtra</b>			
Mjete monetare	5	5,547,580	12,942,427
Llogari të arkëtueshme tregtare	6	15,564,945	17,258,048
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	7	16,174	89,893
Të tjera llogari të arkëtueshme	8	3,540,691	4,018,757
Inventari	9	16,417,732	10,944,318
Shpenzime të shtyra	10	1,577,924	10,469,679
<b>Total aktive afatshkurtra</b>		<b>42,665,046</b>	<b>55,723,122</b>
<b>Aktivitet afatgjata</b>			
Aktive afatgjata materiale	11	23,324,443	17,109,557
Aktive afatgjata jomateriale	12	9,190	22,142
<b>Total aktive afatgjata</b>		<b>23,333,633</b>	<b>17,131,699</b>
<b>Total aktive</b>		<b>65,998,679</b>	<b>72,854,821</b>
<b>DETYRIMET</b>			
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
Hua afatshkurtra	13	3,941,809	23,435
Llogari të pagueshme tregtare	14	6,197,506	3,714,066
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	15	16,592,139	18,966,423
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara	16	12,583	11,750
Detyrime tatimore	17	477,298	661,723
Të ardhurat e shtyra	18	-	5,086,215
Të tjera detyrime	19	19,019	19,001
<b>Total detyrime afatshkurtra</b>		<b>27,240,354</b>	<b>28,482,613</b>
<b>Detyrime afatgjata</b>			
Hua afatgjata	20	2,059,193	-
<b>Total detyrime afatgjata</b>		<b>2,059,193</b>	<b>-</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>29,299,547</b>	<b>28,482,613</b>
<b>KAPITALI</b>			
Kapitali i nënshkruar		100	100
Rezerva ligjore		10	10
Rezerva të tjera		34,372,098	34,153,675
Fitimi i ushtrimit		2,326,924	10,218,423
<b>Total kapitali</b>	21	<b>36,699,132</b>	<b>44,372,208</b>
<b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>		<b>65,998,679</b>	<b>72,854,821</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Pasqyra e Performancës**

**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	22	107,343,352	73,045,818
Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces		(532,191)	532,191
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit neto	23	710,107	216,743
<b>Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme</b>		<b>(80,330,252)</b>	<b>(43,167,016)</b>
1) Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	24	(72,897,883)	(37,335,580)
2) Të tjera shpenzime	25	(7,432,369)	(5,831,436)
<b>Shpenzime të personelit</b>	26	<b>(19,840,066)</b>	<b>(14,621,280)</b>
1) Paga dhe shpërblime		(17,583,022)	(13,019,161)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore		(2,257,044)	(1,602,119)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	11/12	(4,151,855)	(3,420,011)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	27	(58)	(2,012)
<b>Shpenzime financiare</b>	28	<b>(381,914)</b>	<b>(481,731)</b>
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		(168,124)	(94,277)
2) Shpenzime të tjera financiare		(213,790)	(387,454)
<b>Fitimi/humbja para tatimit</b>		<b>2,817,123</b>	<b>12,102,702</b>
<b>Shpenzimi i tatimit mbi fitimin</b>	29	<b>(490,199)</b>	<b>(1,884,279)</b>
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(490,199)	(1,884,279)
2) Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë		-	-
<b>Fitimi/humbja e vitit</b>		<b>2,326,924</b>	<b>10,218,423</b>
<b>Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>2,326,924</b>	<b>10,218,423</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Inform Albania Shpk**

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital  
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Rezerva të tjera	Fitim / Humbja e vitit	Totali
<b>Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017</b>	<b>100</b>	<b>10</b>	<b>26,944,997</b>	<b>17,502,015</b>	<b>44,447,122</b>
Fitimi / Humbja e vitit	-	-	-	10,218,423	10,218,423
Lëvizjet përmes kapitalit	-	-	17,502,015	(17,502,015)	-
Dividendë të paguar	-	-	(10,293,337)	-	(10,293,337)
<b>Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2018</b>	<b>100</b>	<b>10</b>	<b>34,153,675</b>	<b>10,218,423</b>	<b>44,372,208</b>
Fitimi / Humbja e vitit	-	-	-	2,326,924	2,326,924
Lëvizjet përmes kapitalit	-	-	10,218,423	(10,218,423)	-
Dividendë të paguar	-	-	(10,000,000)	-	(10,000,000)
<b>Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2019</b>	<b>100</b>	<b>10</b>	<b>34,372,098</b>	<b>2,326,924</b>	<b>36,699,132</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 u aprovuan dhe u nënshkruan si më poshtë më 20 shkurt 2020:

Elvis Sula

Elvis Sula  
Administrator

**INFORM  
ALBANIA Shpk**  
NIPT L11518003F - Tirana (Albania)

Mazars Shpk

Mazars shpk  
Hartues i Pasqyrave

**M MAZARS**

Rr. Emin Duraku, Pall "Binjaket",  
No.5, 1000, Tirana, Albania  
phone: +355 42 27 80 15  
www.mazars.al, info@mazars.al

**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare  
Për Vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
<b>Flukset e parasë nga aktivitetet operative</b>		
Fitim / Humbja e vitit	2,326,924	10,218,423
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Diferenca këmbimi jo nga aktivitetet operative	(10,555)	342,201
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	4,151,855	3,420,011
Vlera kontabël e aseteve të dala jashtë përdorimit	-	43,022
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	11,136,643	(2,897,667)
Rënie/(rritje) në inventarë	(5,473,414)	(232,932)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	(15,160,633)	9,834,054
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	-	2,641
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit</b>	<b>(3,029,180)</b>	<b>20,729,753</b>
<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit</b>		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(10,353,789)	(2,699,769)
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit</b>	<b>(10,353,789)</b>	<b>(2,699,769)</b>
<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit</b>		
Hua të arkëtuara	5,977,567	-
Pagesa e huave	-	(1,712,498)
Dividendë të paguar	-	(10,293,337)
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit</b>	<b>5,977,567</b>	<b>(12,005,835)</b>
<b>Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare</b>	<b>(7,405,402)</b>	<b>6,024,149</b>
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	12,942,427	7,260,479
<i>Efekt i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i>	10,555	(342,201)
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor</b>	<b>5,547,580</b>	<b>12,942,427</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



## **1. Informacion i përgjithshëm**

“Inform Albania” sh.p.k (Kompania) është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më 18 Mars 2011 në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 100 Lek, i ndarë në 2 kuota.

Ortakët e shoqërisë janë:

- Albdesign PSP zotërues i 24.5% të kapitalit të shoqërisë;
- Inform P.Lykos S.a Processing & Development of Printed Information System zotërues i 75.5% të kapitalit të shoqërisë.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është shitje e shtypshkrimeve dixhitale dhe menaxhim i të gjitha llojeve të dokumenteve dhe shtypshkrimeve. Tregti e të gjitha produkteve të ngjashme dhe makinerive që lidhen me këtë lloj aktiviteti. Shtypshkrim dhe menaxhim i dokumenteve me elemente sigurie. Përfaqësim në Shqipëri i shoqërive të huaja me aktivitet të ngjashëm.

Selia e shoqërisë është në adresën: Rruga: “Çerçiz Topulli, Objekti nr 17, Kashar, Tiranë.

Më 31 dhjetor 2019 Shoqëria kishte 18 punonjës (2018: 17 punonjës).

## **2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare**

### **2.1. Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.25/2018, datë 10 maj 2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Në bazë të urdhrin nr.64 datë 22.7.2014 “Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”, Ministria e Financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119 datë 1 gusht 2014.

### **2.2. Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

### **2.3. Biznesi në vijimësi**

Pasqyrat financiare të shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

### **2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e shoqërisë.

### **2.5. Vlerësime dhe gjykime**

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumë e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo

## **2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)**

### **2.5. Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)**

gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë.

#### **2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme**

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga paaftësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çrregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

#### **2.5.2. Provizionet**

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit që mund të masë me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

## **3. Politikat kontabël**

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

### **3.1. Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është detajuar si më poshtë:

<b>Kursi i këmbimit</b>	<b>2019</b>	<b>2018</b>
Euro/ALL	121.77	123.42
USD/ ALL	108.64	107.82

### **3.2. Instrumentat financiarë**

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë.

### **3. Politikat kontabël (vazhdim)**

#### **3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)**

Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

#### *Mjetet monetare*

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

#### *Llogari të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

#### *Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

#### *Hua të marra dhe të dhëna*

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

#### *Vlera e drejtë*

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, për afrohen me vlerat e tyre kontabël.

#### *Të tjera*

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

#### *Zhvlerësimi i aktiveve financiare*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

### **3. Politikat kontabël (vazhdim)**

#### **3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)**

##### *Zhvlerësimi i aktiveve financiare (vazhdim)*

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### **3.3. Inventarët**

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

#### **3.4. Aktive afatgjata materiale**

##### *i. Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivit afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

##### *ii. Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

##### *iii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

**3. Politikat kontabël (vazhdim)****3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)**

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2019 dhe 2018 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje dhe orendi	Vlerë e mbetur	20%
Pajisje informatike	Vlerë e mbetur	25%
Makineri dhe pajisje	Vlerë e mbetur	20%
Automjete	Vlerë e mbetur	20%
Të tjera	Vlerë e mbetur	20%

**iv. Çregjistrimi**

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

**3.5. Të ardhurat**

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

**3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit**

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

**3.7. Qiratë**

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

**3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

### **3. Politikat kontabël (vazhdim)**

#### **3.9. Tatimi mbi fitimin**

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 15% (2018: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

#### **3.10. Fondet për pensione**

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

#### **3.11. Transaksionet me palët e lidhura**

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

#### **3.12. Provizionet**

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

#### **3.13. Aktivitet dhe Detyrimet e Kushtëzuara**

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

**4. Vlerësimet kritike të kontabilitetit**

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, menaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në kompani. Ndërsa masat kufizuese vazhdojnë, volumi i shitjeve, fluksi i parasë, zhvlerësimi i aktiveve, inventari, vlera e drejtë dhe fitimi mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, kompania po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijmësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.

**5. Mjete monetare**

Mjetet monetare në arkë dhe bankë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Mjete monetare në bankë	5,465,633	12,922,001
Llogari rrjedhëse	5,465,633	12,922,001
Mjete monetare në arkë	81,947	20,426
	<u><b>5,547,580</b></u>	<u><b>12,942,427</b></u>

**6. Llogari të arkëtueshme tregtare**

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Klientë	15,564,945	17,258,048
	<u><b>15,564,945</b></u>	<u><b>17,258,048</b></u>

**7. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura**

Të arkëtueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Të arkëtueshme tregtare nga Albdesign PSP	16,174	89,893
	<u><b>16,174</b></u>	<u><b>89,893</b></u>

**8. Të tjera llogari të arkëtueshme**

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Tatim mbi fitimin	1,822,400	1,325,434
TVSH e kreditueshme	360,216	2,386,570
Detyrime doganore	164,736	146,753
Të tjera kërkesa të arkëtueshme	1,193,339	160,000
	<u><b>3,540,691</b></u>	<u><b>4,018,757</b></u>

**9. Inventari**

Gjendja e inventarit më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Lëndë e parë dhe materiale	16,344,580	10,144,009
Mallra për rishitje	73,152	268,118
Produkt i gatshëm	-	532,191
	<u><b>16,417,732</b></u>	<u><b>10,944,318</b></u>

**10. Shpenzime të shtyra**

Shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Shpenzime të periudhave të ardhme	1,577,924	10,469,679
	<u><b>1,577,924</b></u>	<u><b>10,469,679</b></u>



**Inform Albania Shpk**

**Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

(Vlerat janë në Lek)

**11. Aktive afatgjata materiale**

	<b>Makineri Pajisje</b>	<b>Automjetet</b>	<b>Mobilje orendi</b>	<b>Paisje kompjuterike</b>	<b>Të tjera</b>	<b>Totali</b>
<b>Kosto</b>						
Gjendja më 31 dhjetor 2017	47,030,472	953,836	73,041	3,350,524	3,261,756	<b>54,669,629</b>
Shtesa	-	-	-	2,346,873	352,896	<b>2,699,769</b>
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	(125,000)	<b>(125,000)</b>
<b>Gjëndja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>47,030,472</b>	<b>953,836</b>	<b>73,041</b>	<b>5,697,397</b>	<b>3,489,652</b>	<b>57,244,398</b>
Shtesa	9,991,154	-	-	74,435	288,200	<b>10,353,789</b>
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	-	-
<b>Gjëndja më 31 dhjetor 2019</b>	<b>57,021,626</b>	<b>953,836</b>	<b>73,041</b>	<b>5,771,832</b>	<b>3,777,852</b>	<b>67,598,187</b>
<b>Amortizimi i akumuluar</b>						
Gjendja më 31 dhjetor 2017	31,961,144	546,867	39,227	2,412,513	1,850,008	<b>36,809,759</b>
Amortizimi i vitit	2,778,369	81,394	6,765	234,503	306,029	<b>3,407,060</b>
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	(81,978)	<b>(81,978)</b>
<b>Gjëndja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>34,739,513</b>	<b>628,261</b>	<b>45,992</b>	<b>2,647,016</b>	<b>2,074,059</b>	<b>40,134,841</b>
Amortizimi i vitit	2,977,813	65,115	5,411	778,102	312,462	<b>4,138,903</b>
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	-	-
<b>Gjëndja më 31 dhjetor 2019</b>	<b>37,717,326</b>	<b>693,376</b>	<b>51,403</b>	<b>3,425,118</b>	<b>2,386,521</b>	<b>44,273,744</b>
<b>Vlera neto kontabël</b>						
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2017</b>	<b>15,069,328</b>	<b>406,969</b>	<b>33,814</b>	<b>938,011</b>	<b>1,411,748</b>	<b>17,859,870</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>12,290,959</b>	<b>325,575</b>	<b>27,049</b>	<b>3,050,381</b>	<b>1,415,593</b>	<b>17,109,557</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2019</b>	<b>19,304,300</b>	<b>260,460</b>	<b>21,638</b>	<b>2,346,714</b>	<b>1,391,331</b>	<b>23,324,443</b>

**12. Aktive afatgjata jo materiale**

	<b>AAJM</b>	<b>Total</b>
<b>Me kosto</b>		
Gjendja më 31 dhjetor 2018	86,346	<b>86,346</b>
Shtesa	-	-
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	<b>86,346</b>	<b>86,346</b>
<b>Amortizimi</b>		-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	64,204	<b>64,204</b>
Amortizimi i vitit	12,952	<b>12,952</b>
Gjendja më 31 dhjetor 2019	77,156	<b>77,156</b>
<b>Gjendja Neto më 31 dhjetor 2018</b>	<b>22,142</b>	<b>22,142</b>
<b>Gjendja Neto më 31 dhjetor 2019</b>	<b>9,190</b>	<b>9,190</b>

**13. Hua aftashkurta**

Në këtë zë është paraqitur overdrafti nga bankat dhe qiratë financiare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<b>31 dhjetor 2019</b>	<b>31 dhjetor 2018</b>
Overdraft Raiffeisen Bank	3,390,258	-
Raiffeisen Leasing Financial lease	551,551	-
Porsche Leasing Financial lease	-	23,435
<b>3,941,809</b>	<b>3,941,809</b>	<b>23,435</b>

**14. Llogari të pagueshme tregtare**

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2019</b>	<b>31 dhjetor 2018</b>
Furnitorë vendas	3,088,560	1,756,088
Furnitorë të huaj	3,108,946	1,957,978
<b>6,197,506</b>	<b>6,197,506</b>	<b>3,714,066</b>

**15. Të pagueshme ndaj palëve të lidhura**

Të pagueshmet ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2019</b>	<b>31 dhjetor 2018</b>
Të pagueshme tregtare	6,592,139	18,966,423
Divident Inform P Lykos	7,550,000	-
Divident Albdesign PSP	2,450,000	-
<b>16,592,139</b>	<b>16,592,139</b>	<b>18,966,423</b>

**16. Të pagueshme për shpenzime të konstatuara**

Të pagueshmet për shpenzime të konstatuara më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Furnitorë për fatura të pambërritura	12,583	11,750
	<u><b>12,583</b></u>	<u><b>11,750</b></u>

**17. Detyrime tatimore**

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	307,833	240,685
Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi	131,702	109,082
Tatim në burim	37,763	311,956
	<u><b>477,298</b></u>	<u><b>661,723</b></u>

**18. Të ardhura të shtyra**

Të ardhurat e shtyra për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Parapagime Vodafone	-	5,086,215
	<u>-</u>	<u><b>5,086,215</b></u>

**19. Të tjera detyrime**

Detyrimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Detyrime ndaj personelit	2,656	2,638
Të tjera detyrime	16,363	16,363
	<u><b>19,019</b></u>	<u><b>19,001</b></u>

**20. Hua afatgjata**

Huatë afatgjata paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Qira financiare Raiffeissen Leasing	2,059,193	-
	<u><b>2,059,193</b></u>	<u>-</u>

**21. Kapitali themeltar**

Kapitali i shoqërisë "Inform Albania" sh.p.k. është 100 Lekë, i ndarë në 2 kuota.

Kapitali i shoqërisë nuk ka ndryshuar gjate 2019.

**22. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit**

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</b>
Të ardhura nga shitja e produktit të vetë	105,718,047	70,023,340
Të ardhura nga shitja e mallrave	1,176,529	560,882
Të ardhura nga shërbimet	448,776	2,461,596
	<b>107,343,352</b>	<b>73,045,818</b>

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së dhe Tatim Fitimit.

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</b>
<b>Rakordimi i të ardhurave me FDP-në</b>	
Shitje total të deklaruara në FDP TVSH	105,718,252
Rrimarje te parapagimeve gjatë vitit	5,057,813
Zbritje nga shitjet për arkëtim në avancë	213,790
Diferenca kursi nga parapagimet	19,889
Vlera e shitjes së makinerisë për tu finacuar me Leasing, deklaruar për neto në deklaratë	(3,660,300)
Rifaturim kostosh kaluar në ulje shpenzimesh	(6,092)
<b>Shitje të deklaruara në FDP që janë të ardhura në PASH</b>	<b>107,343,352</b>
Shitje produkte të gatshme	105,718,047
Shitje mallrash	1,176,529
Shërbime	448,776
<b>Të ardhura të deklaruara në PASH të cilat janë deklaruar shitje në FDP</b>	<b>107,343,352</b>
Fitim nga këmbimet valutore	862,006
<b>Total të ardhura të deklaruara FDP e Tatim Ftimit</b>	<b>108,205,358</b>

**23. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit neto**

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</b>
Fitime nga këmbimet valutore	862,006	1,088,133
Humbje nga këmbimet valutore	(151,899)	(871,390)
Të ardhura nga shitja e aktiveve afatgjata riblerë me Leasing	3,660,300	-
Vlera neto kontabël e asetëve të shitura riblerë me Leasing	(3,660,300)	-
	<b>710,107</b>	<b>216,743</b>

**24. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme**

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndeve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen më veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</b>
Kosto e materialeve të para	47,076,193	25,578,489
Kosto e materialeve të ambalazhimit	2,205,579	621,726
Pjesë këmbimi	2,822,582	1,578,963
Materiale të tjera ndihmëse	137,626	26,249
Kosto e mallrave të shitur	804,499	411,557
Nënkontraktorë	13,615,164	3,365,697
Mirëmbajtje dhe riparime makinerite dhe fabrika	987,736	341,505
Qira	3,184,659	3,292,129
Prime sigurimi	93,524	142,780
Energji elektrike	1,370,998	760,523
IT Servis	599,323	1,215,962
	<b>72,897,883</b>	<b>37,335,580</b>

**25. Të tjera shpenzime**

Shpenzimet e tjera paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</b>
Konsulenca ekonomike dhe juridike	2,117,549	2,308,237
Blerje të ndryshme, kancelari etj	1,597,981	475,860
Shpenzime për licence software, konfigurim , setup	1,141,075	1,202,570
Mirëmbajtje dhe riparime	542,914	146,544
Shpenzime të ndryshme dhe të panjohura	377,421	296,564
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	301,554	265,439
Shërbime nga të tretë	265,648	270,526
Shpenzime pjesëmarrje në tender	249,800	-
Komisione bankare	219,691	165,703
Taksa te ndryshme	203,598	199,000
Shpenzime administrative dhe noteriale	185,580	122,997
Kosto udhëtimi dhe akomodimi teknikët	161,454	205,716
Siguracione	39,890	86,865
Shpenzime udhëtimi dhe dieta	28,214	26,195
Dhurata	-	59,220
	<b>7,432,369</b>	<b>5,831,436</b>

**26. Shpenzime të personelit**

Shpenzimet e personelit paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</b>
Shpenzime për paga	17,583,022	13,019,161
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	2,257,044	1,602,119
	<b>19,840,066</b>	<b>14,621,280</b>

**27. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit**

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</b>
Gjopa dhe penalitete	58	2,012
	<b>58</b>	<b>2,012</b>

**28. Shpenzime financiare**

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatin nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërisë. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</b>
Shpenzime për interesa	(168,124)	(94,277)
Zbritje nga shitjet për arkëtim në avancë	(213,790)	(387,454)
	<b>(381,914)</b>	<b>(481,731)</b>

**Inform Albania Shpk**  
**Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

(Vlerat janë në Lek)

**29. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin**

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<b>31 dhjetor 2019</b>	<b>31 dhjetor 2018</b>
<b>Fitimi para tatimit</b>	<b>2,817,123</b>	<b>12,102,702</b>
<b>Shpenzime te panjohura te tjera (si më poshtë)</b>	<b>450,871</b>	<b>459,157</b>
Shpenzime pritje dhe percjellje, dhurata	-	59,220
Shpenzime udhëtimi	3,500	3,000
Penalitet, gjoba e dëmshpërblime	58	2,012
Vlera neto e aseteve të dala jashtë përdorimi	-	43,022
Shpenzime të tjera	447,313	351,903
<b>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</b>	<b>3,267,994</b>	<b>12,561,859</b>
<b>Tatim fitimi 15%</b>	<b>490,199</b>	<b>1,884,279</b>
	<b>2,326,924</b>	<b>10,218,423</b>

**30. Transaksionet me palët e lidhura**

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2019</b>	<b>31 dhjetor 2018</b>
<b>Bilanci kontabël</b>		
<i>Të pagueshme ndaj palëve të lidhura</i>		
Inform P.Lykos SA	12,317,453	3,562,187
Albdesign PSP	4,274,686	15,404,236
	<b>16,592,139</b>	<b>18,966,423</b>
<i>Të arkëtueshme nga palët e lidhura</i>		
Albdesign PSP	16,174	89,893
	<b>16,174</b>	<b>89,893</b>

Detajet e transaksioneve me palët e lidhura gjatë vitit të mbyllur me 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</b>
<b>Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve</b>		
<i>Shitje palëve të lidhura</i>		
Albdesign PSP	1,502,133	1,868,168
	<b>1,502,133</b>	<b>1,868,168</b>
<i>Blerje nga palët e lidhura</i>		
Inform P.Lykos SA	21,127,126	11,334,761
S.C. INFORM LYKOS S.A.	1,121,760	1,200,960
Albdesign PSP	14,358,369	21,050,242
	<b>36,607,255</b>	<b>33,585,963</b>

### **31. Angazhime dhe pasiguri**

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të kenë efekt negativ në pozicionin financiar të shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj.

Më 31 dhjetor 2019 shoqëria nuk ka angazhime kapitale të kontraktuara por ende të papaguara.

### **32. Ngjarje pas bilancit**

Më 11 Mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetit e deklaroi koronavirusin (COVID-19) një pandemi. Ndërsa situata është ende duke u zhvilluar në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Menaxhimi pret që zhvlerësimi i aktiveve, inventari, vlera e drejtë, të ndikohen nga situata. Impakti financiar do të njihet nga Kompania gjatë vitit 2020. Menaxhimi do të vazhdojë të monitorojë ndikimin e mundshëm dhe do të ndërmarrë të gjitha hapat e mundshëm për të lehtësuar çdo efekt. Menaxhimi e konsideron këtë pandemi si një ngjarje që nuk rregullohet pas datës së raportimit dhe e ka shpalosur në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare. Efektet mbi bazën e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare janë shpalosur në shënimin 4 "vlerësimet kritike të kontabilitetit" të këtyre pasqyrave financiare.